



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

KONTRATA

NUMRI I KONTRATËS: **101-22-5405-1-3-5/C82**

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

Ndërmarrja Tregtare Grafike BLENDI O.P., Adresa: *Gustav Majer Nr.13, Prishtinë*; E-mail: *prokurimi.ntgblend@gmail.com*; Tel.: *+383 44 916 288*; Numri Unik Identifikues: *810446072*; (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizimi me letër univerzale për kopje

me numër prokurimi: **101-22-5405-1-3-5 (KU101 22 023 135)**

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Furnizimi me letër univerzale për kopje-178 pako**
- 1.2 Kontrata hyn në fuqi më **14.06.2022** dhe përfundon më **16.06.2022**
- 1.3 Afati kohor i furnizimit duhet të jetë **3** ditë nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.
- 1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë: **Kuvendi i Republikës së Kosovës.**
- 1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **3,960.50 €** (me fjalë: tremijë e nëntëqindëgjashtëdhjetë euro e pesëdhjetë centë)
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **furnizimeve** duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për **12 muaj**, pas pranimit të **furnizimeve**.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat** brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me **0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej **10 % të vlerës totale të kontratës**.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatë (*shih KVK*) në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

KUSHTET E VEÇANTA TË KONTRATËS

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha		Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	1	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Siguria e ekzekutimit		Shuma e sigurisë së ekzekutimit 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj pas përfundimit të kontratës
Programi i ekzekutimit	1.3	Furnizimi me letër univerzale për kopje duhet të bëhet në afat prej 3 ditësh nga hyrja në fuqi e kontratës.
Pagesa	4.	Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas furnizimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se furnizimeve janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë
Cilësia e furnizimeve	6	Të gjitha furnizimet duhet të jenë në pajtim me kërkesat e specifikacionit teknik në Dosje të Tenderit në aspektin e cilësisë, formës dhe dimensionit. Furnizimet që nuk janë funksionale do t'i kthehen OE edhe pas pranimit të tyre gjatë periudhës së kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	12	Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese:
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	13	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.

Shënim:

Kontratës i bashkëngjitet kopja e ofertës financiare të Operatorit ekonomik dhe kopja e sigurisë së ezekutimit.

Për Autoritetin Kontraktues KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS		Për Operatorin ekonomik Ndërmarrja Tregtare Grafike BLENDI O.P.	
Emri dhe mbiemri	Xhemail Halili	Emri dhe mbiemri	Agim Kurti
Pozita:	Drejtor i Drejtorisë për Prokurim	Pozita:	Zyrtar Administrativ
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.06.2022	Data:	14.06.2022
Vula:		Vula:	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Përkrahimi i çmimit -Furnizimi me letër univerzale për kopje
Nr. i prokurimit: 101-22-5405-1-3-5 dhe Nr. i brendshëm: KUJ01 22 023 135

Nr.r.	Emërtimi	Specifikacioni teknik	Pamja/Dukja/Foto Ekuivalent	Njësia matëse	Çmimi pa TVSH			Vlera e TVSH	Çmimi me TVSH	Totali me TVSH
					Sasia	a	b			
1	Letër univerzale per kopje A4/80g/m2	Letër e bardhë për kopje bardhe e zi, multifunksionale, perdorim zyre ne baza ditore.Pershtatet per te gjitha printeret dhe makina fotokopjuese.Madhësia A4 me dim:(210x297)mm; (80-90) g/m², 5 x 500 flete/ris.		pako	178	18.8559322	18%	3.394067797	22.25	3960.5
TOTALI I OFERTËS ME TVSH (Euro)										
3,960.50										

Shënim:

Operatorë ekonomikë duhet t'i japin çmimet reale të tregut për produktet e ofruar. Çmimet jo-normalisht të ulëta dhe çmimet më të larta se çmimet reale të tregut do të trajtohen në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)

Emri i OE:

NTG BLENDI

Emri dhe mbiemri i perfaqesuesit te OE:

SHAIP RAMA

Nenshkrimi:

Data:

08.06.2022

Vula:



SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **Kuvendi I Republikës së Kosovës**
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **NTG Blendi O.P. , GUSTAV MAJER NR.13**
(në vazhdim "operatori ekonomik").

Prishtine

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: Titulli: Furnizimi me letër univerzale për kopje

101-22-5405-1-3-5
KU101 22 023 135

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Tre qinde e Nentëdhjete e Gjashtë e Pes 396.05 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **396.05 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **33 ditë** prej **13.06.2022** deri më **16.07.2022**

Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në menyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i bankës ose i institucionit financiar

K.S. "SIGKOS" Sh.a.
Lagjja Kalabria, Kompleksi Riera, Hyrja Z10, Magjistralja
Prishtinë-Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data

13.06.2022